



“ARB&TRANS-2010” SHPK

Mobile:+355684007474

Email: arbtrans@yahoo.com

Address: Rruga "Astrit Balluku" , zone kadastrale 8250 ,nr pasurie 5/700 ,Tirane

POLITIKA E PRIVATËSISË

1. Hyrje

ARB & TRANS – 2010 shpk respekton privatësinë e vizitorëve dhe klientëve të saj dhe angazhohet për mbrojtjen e të dhënave personale që përpunohen nëpërmjet faqes sonë zyrtare të internetit.

Kjo Politikë Privatësie shpjegon mënyrën se si shoqëria mbledh, përdor, ruan dhe mbron të dhënat personale të përdoruesve që vizitojnë faqen tonë të internetit ose përdorin shërbimet tona online.

Duke përdorur këtë faqe interneti, përdoruesi pranon kushtet e kësaj Politike Privatësie.

2. Objekti i kësaj rregullore

Kjo rregullore ka për objekt informimin e subjekteve të të dhënave personale mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë që janë marrë për të dhënat e tyre në lidhje me këtë faqe web-i.

Përpunimi i të dhënave personale kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë:

1. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
2. Ligjin Nr. 124, datë 19.12.2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
3. Aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë mbrojtjen e privatësisë.

Administratori i faqes së web-it, kryen përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private.

3. Të dhënat personale që mund të mblidhen

Gjatë përdorimit të faqes sonë të internetit mund të mblidhen të dhëna personale, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

1. Emrin dhe mbiemrin.
2. Numrin e telefonit.
3. Adresën e emailit.
4. Informacione të dërguara përmes formularëve të kontaktit.
5. Informacione lidhur me interesin për projekte ndërtimi, njësi për shitje ose bashkëpunime.

Gjithashtu mund të mblidhen automatikisht disa të dhëna teknike si:

1. Adresa IP.
2. Lloji i shfletuesit dhe pajisjes.
3. Data dhe ora e aksesit në faqe.
4. Informacione të navigimit në faqe.



“ARB&TRANS-2010” SHPK

Mobile:+355684007474

Email: arbtrans@yahoo.com

Address: Rruga "Astrit Balluku" , zone kadastrale 8250 ,nr pasurie 5/700 ,Tirane

4. Qëllimi i përpunimit të të dhënave

Të dhënat personale përpunohen për qëllimet e mëposhtme:

1. Komunikimin me klientët dhe vizitorët e faqes.
2. Ofrimin e informacionit mbi projektet dhe shërbimet e kompanisë.
3. Përpunimin e kërkesave për informacion, ofertë ose bashkëpunim.
4. Përmirësimin e funksionalitetit dhe performancës së faqes së internetit.
5. Administrimin e marrëdhënieve me klientët dhe partnerët.

5. Mbrojtja e të dhënave

Mbrojtja e të dhënave bazohet në:

1. Përpunimin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;
2. Grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime;
3. Mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
4. Saktësinë që të dhënat duhet të kenë dhe, kur është e nevojshme, duhet të përditësohen duhet ndërmarrë çdo hap i arsyeshëm për të fshirë apo korigjuar të dhëna të pasakta apo të paplota, në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur apo për të cilin përpunohen më tej;
5. Mbjajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

6. Siguria e të dhënave

Shoqëria merr masa teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.

Këto masa synojnë të mbrojnë të dhënat nga:

1. akses i paautorizuar.
2. përdorim i paligjshëm.
3. humbje, ndryshim ose shkatërrim i të dhënave.

7. Shpërndarja e të dhënave

Shoqëria nuk ndan të dhënat personale të përdoruesve me palë të treta, përveç rasteve kur:

1. kërkohet nga legjislacioni në fuqi.
2. është e nevojshme për ofrimin e shërbimeve.
3. përdoruesi ka dhënë pëlqimin e tij të qartë.

□



“ARB&TRANS-2010” SHPK

Mobile:+355684007474

Email: arbtrans@yahoo.com

Address: Rruga "Astrit Balluku" , zone kadastrale 8250 ,nr pasurie 5/700 ,Tirane

8. Të drejtat e subjekteve të të dhënave

8.1. E drejta për akses

1. Çdo person ka të drejtë që pa pagesë me kërkesë me shkrim, të marrë nga kontrolluesi:

- Konfirmimin nëse të dhënat personale po i përpunohen ose jo, informacion për qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave të përpunuara dhe për marrësit e kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat personale;

2. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, informon subjektin e të dhënave ose i shpjegon atij arsyet e mosdhënies së informacionit.

Kontrolluesi

ARB & TRANS – 2010 sh.p.k

Rr. Astrit Balluku, ZK 8250, Nd. 5/700, Tiranë, Shqipëri.

Web: <https://arbtrans.al/>

8.2. E drejta për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen

1. Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave pa pagesë, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e bllokimit, korrigjimit apo të fshirjes.

3. Kur kontrolluesi nuk bën bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të kërkuara prej tij, subjekti i të dhënave ka të drejtë të ankohet te komisioneri.

9. Cookies dhe teknologjitë e ngjashme

Faqja jonë e internetit mund të përdorë cookies dhe teknologji të tjera për të përmirësuar eksperiencën e përdoruesit dhe për të analizuar trafikun në faqe.

Përdoruesit mund të menaxhojnë ose çaktivizojnë cookies përmes cilësimeve të shfletuesit të tyre.

10. Lidhje me faqe të tjera

Faqja jonë mund të përmbajë lidhje me faqe të tjera interneti. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për praktikatat e privatësisë të këtyre faqeve.



“ARB&TRANS-2010” SHPK

Mobile:+355684007474

Email: arbtrans@yahoo.com

Address: Rruga "Astrit Balluku" , zone kadastrale 8250 ,nr pasurie 5/700 ,Tirane

11. Ndryshime në këtë politikë

Shoqëria rezervon të drejtën të përditësojë këtë Politikë Privatësie në çdo kohë për të reflektuar ndryshime ligjore ose operacionale.

Versioni më i fundit do të publikohet në faqen tonë zyrtare.

12. Kontakt

Për çdo pyetje ose kërkesë lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale mund të kontaktoni:

ARB & TRANS – 2010 sh.p.k

Rr. Astrit Balluku, ZK 8250, Nd. 5/700, Tiranë, Shqipëri

Email: info@arbtrans.al;

Website: <https://arbtrans.al/>

13. E drejta për tu ankuar

Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë.

Komisioneri për Mbrojtjen e të dhënave

Rruga A. Toptani, Nd.5, Kodi postar 1001, Tiranë.

<http://www.idp.al>;

Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, kontrolluesi nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar.